

20212884517

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MARRËDHËNIE PUNE

Neni 1

Në Ligjin e Marrëdhënieve të Punës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27 / 16, 120/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 110/19 dhe 267/20), në nenin 106 në paragrafin (3) pas fjalëve “të përcaktuara me ligj”, vendoset presje dhe shtohen fjalët “punë ditën e diel”.

Neni 2

Në nenin 134, paragrafi (2) ndryshon dhe thotë:

“(2) Ditë e pushimit javor është dita e diel”.

Pas paragrafit (2) shtohen shtatë paragrafë të rinj (3), (4), (5), (6), (7), (8) dhe (9), të cilët thonë:

“(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) të këtij neni, për punonjësit te punëdhënësit procesi i punës i të cilëve është i një natyre të tillë që nuk mund të ndërpritet për shkak të procesit tekniko-teknologjik dhe nevojës për vazhdimësi në punë, ditë e pushimit javor mund të jetë një ditë tjetër e javës, edhe atë në veprimtaritë:

- përkujdesja e kafshëve
- fermeri e përzier
- nxjerrja e qymyrit dhe linjtit,
- nxjerrja e mineraleve të metalit,
- shtypja dhe botimi i gazetave,
- prodhimi i bukës, ëmbëlsirave të freskëta dhe biskotave,
- prodhimi i të birrës, vetëm në proceset që lidhen me zierjen, përgatitjen dhe monitorimin e majave, fermentimin, filtrimin dhe mbështetjen energjetike të këtyre proceseve;
- prodhimi i produkteve farmaceutike bazë dhe preparateve farmaceutike;
- prodhimi i pllakave, fletëve, tubave dhe profileve të masave plastike,
- prodhimi i gazit industrial,
- prodhimi i metaleve,
- farmacitë,
- furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe kondicioner,
- furnizimi me ujë, largimi i ujërave të zeza, menaxhimi i mbetjeve dhe veprimtari të rehabilitimit të mjedisit,
- transporti tokësor, gypor, ujqor dhe ajror,
- magazinimi dhe veprimtaritë ndihmëse në transport,
- objektet e akomodimit,
- veprimtaritë për përgatitjen e vakteve dhe shërbimit të ushqimit,
- veprimtaria e filmit, veprimtaritë për video dhe program televiziv,
- transmetim programi,
- telekomunikacionet,
- veprimtaritë shërbyese informative (hostimi, përpunimi i të dhënave, portalet e internetit, etj.),
- prezantimi i filmave,
- veprimtaritë fotografike,
- veprimtaritë e veterinarisë,
- marrja dhe dhënia me qira (lizing) e automjeteve motorike,

- veprimtaritë e mbrojtjes private dhe shërbimet e mbrojtjes me ndihmën e sistemeve të sigurisë,

- veprimtaritë e qendrave të thirrjeve,

- veprimtaritë e përgjithshme të administratës publike, vetëm për çështje urgjente që ndërlihen me seanca, mbikëqyrje inspektuese, ruajtje të pyjeve, e që kanë rëndësi vitale për interesin shtetëror dhe publik,

- çështje të mbrojtjes,

- veprimtaritë gjyqësore dhe të jurisprudencës,

- çështje të rendit publik dhe sigurisë,

- veprimtari e shërbimit zjarrfikës,

- veprimtari për mbrojtje shëndetësore,

- veprimtari të mbrojtjes sociale me akomodim,

- veprimtari kreative, artistike dhe argëtuese,

- veprimtari të muzeve,

- veprimtaritë e kopshteve zoologjike dhe rezervateve natyrore,

- veprimtaritë sportive, argëtuese dhe rekreative,

- veprimtaritë e funeraleve dhe të ngjashme,

- shërbimi doganor i pikave kufitare,

- veprimtari që kanë karakterin e aktiviteteve ndihmëse ose shoqëruese me qëllim të funksionimit të papenguar të veprimtarive nga ky paragraf, në bazë të marrëveshjes së lidhur me punëdhënësin nga veprimtaritë nga ky paragraf dhe

- vende pune nga veprimtaritë tjera që nuk janë përfshirë në këtë paragraf e që kanë karakter të punëve ndihmëse dhe shoqëruese për kryerjen e papenguar të veprimtarisë themelore të punëdhënësit.

(4) Punonjësit te punëdhënësit e tregtisë me pakicë dhe tregtisë me shumicë, ditën e pushimit javor nga paragrafi 2 i këtij neni e shfrytëzojnë në pajtim me Ligjin e Tregtisë.

(5) Në rast të fatkeqësive natyrore dhe të tjera, si dhe avarive dhe parandalimit të pasojave prej tyre ose kur një fatkeqësi e tillë pritët të ndodhë, me kërkesë të punëdhënësit, punonjësi është i detyruar të punojë të dielën për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe për të parandaluar dëmin e riparueshëm material.

(6) Punonjësi nga veprimtaritë e paragrafëve (3), (4) dhe (5) të këtij neni, përpos të drejtës për shtesë në rrogë për punë në ditën e diel, ka të drejtë edhe për shfrytëzimin e pushimit javor gjatë shtatë ditëve të ardhshme. Shtesa e rrogës për punë në ditën e diel arrin së paku 50% për çdo orë të kaluar në punë, nëse me ligj dhe marrëveshje kolektive nuk është përcaktuar shumë më e lartë e shtesës.

(7) Në rastet nga paragrafët 3), (4) dhe (5) të këtij neni punëdhënësi është i detyruar që para fillimit të punës ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror të Punës.

(8) Veprimtaritë dhe punët nga paragrafi (3) nënparagrafët 42) dhe 43) të këtij neni i përshkruan ministri kompetent për punët nga sfera e punës.

(9) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e njoftimit nga paragrafi (7) i këtij ligji e përshkruan ministri kompetent për punët nga sfera e punës.

Neni 3

Pas nenit 259 – a shtohet nen i ri 259-b, i cili thotë:

Neni 259-b

“(1) Me përjashtim të nenit 258, paragrafi (1) të këtij ligji, nëse inspektori i punës gjatë mbikëqyrjes inspektuese konstaton se te punëdhënësi punon punonjës ditën e diel, në kundërshtim me nenin 134 të këtij ligji, me vendim do t’i ndalojë punëdhënësit kryerjen e punës në hapësirën e punës ku është konstatuar parregullsia, në afat prej 15 ditëve, do t’i japë

urdhërpagesë kundërvajtëse. Nëse punëdhënësi nuk e pranon urdhërpagesën kundërvajtëse ose nuk e paguan, inspektori kompetent do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje, në pajtim me Ligjin e Kundërvajtjeve.

(2) Nëse punëdhënësi e përsërit kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni, inspektori me vendim do t'i ndalojë kryerjen e punës në hapësirat e punës ose në hapësirën e punës ku është konstatuar parregullsia, në afat prej 30 ditëve dhe do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje, në pajtim me Ligjin e Kundërvajtjeve.

(3) Gjatë ndalesës së punës nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, punëdhënësi është i detyruar t'u paguajë punëtorëve kompensim të rrogës në lartësi të pagës së paguar të punëtorit në muajin paraprak dhe kontribute të pagës dhe gjatë ndalesës nuk mund të zvogëlojë numrin e të punësuarve.

(4) Kundër këtij vendimi nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimi në organin kompetent për vendimmarrje në shkallë të dytë, në pajtim me ligjin .

(5) Ankesa nuk e prolongon ekzekutimin e vendimit nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

(6) Personat e autorizuar zyrtarë janë të detyruar të mbajnë evidencë për fletëpagesat e lëshuara kundërvajtëse dhe për rezultatin e proceduarave të ngritura.

(7) Në evidencën nga paragrafi (6) i këtij neni, këto të dhëna grumbullohen, përpunohen dhe ruhen: emri dhe mbiemri, respektivisht emri i kryesit të kundërvajtjes, vendbanimi, respektivisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës për kundërvajtje të cilit i lëshohet edhe rezultati i procedurës.

(8) Të dhënat personale nga paragrafi (7) i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencë.”

Neni 4

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 60 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 5

Autorizohet Komisioni Juridik-Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit të Marrëdhënieve të Punës.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, kurse do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2022.